FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 9

Tiranë – E premte, 29 janar 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 20.1.2016	Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.....	517
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 20.1.2016	Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Vuno dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj të zonës së mbrojtur përreth.....	525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 20.1.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1555, datë 12.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar.....	533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 20.1.2016	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 871 m², në përgjegjësi administrimi të autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor (ASIG), projektit "Innovation Hub".	535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 20.1.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", të ndryshuar.....	536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 21.1.2016	Për përcaktimin e pagës mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e regjistruar si të vetëpunësuar, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale dhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të.....	536

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 21.1.2016 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat"", të ndryshuar..... 542

VENDIM
Nr. 29, datë 20.1.2016

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT DHËRMI DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores "Për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe të Zonës së Mbrojtur përreth", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËR SHPALLJEN QENDËR HISTORIKE TË DHËRMIUT, HIMARË
KORDINATAT GJEOGRAFIKE

	Gjatësi			Gjerësi		
Pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
QENDËR HISTORIKE 1						
1	40°	9`	8.87``N	19°	38`	7.77``E
2	40°	9`	10.51``N	19°	38`	8.63``E
3	40°	9`	11.94``N	19°	38`	8.52``E
4	40°	9`	12.94``N	19°	38`	8.94``E
5	40°	9`	14.00``N	19°	38`	9.04``E
6	40°	9`	14.57``N	19°	38`	8.43``E
7	40°	9`	16.05``N	19°	38`	10.53``E
8	40°	9`	17.16``N	19°	38`	10.54``E
9	40°	9`	18.47``N	19°	38`	14.48``E
10	40°	9`	18.79``N	19°	38`	16.67``E
11	40°	9`	18.03``N	19°	38`	17.70``E
12	40°	9`	16.67``N	19°	38`	17.73``E
13	40°	9`	15.88``N	19°	38`	18.46``E
14	40°	9`	14.59``N	19°	38`	18.46``E
15	40°	9`	13.30``N	19°	38`	17.25``E
16	40°	9`	11.88``N	19°	38`	15.78``E
17	40°	9`	11.85``N	19°	38`	14.42``E
18	40°	9`	11.24``N	19°	38`	14.05``E
19	40°	9`	10.18``N	19°	38`	12.54``E
20	40°	9`	9.06``N	19°	38`	11.63``E
21	40°	9`	8.14``N	19°	38`	10.37``E
22	40°	9`	7.84``N	19°	38`	9.16``E
QENDËR HISTORIKE 2						
1	40°	9`	17.49``N	19°	38`	21.54``E
2	40°	9`	18.32``N	19°	38`	24.94``E
3	40°	9`	17.51``N	19°	38`	27.44``E
4	40°	9`	16.76``N	19°	38`	29.21``E
5	40°	9`	14.93``N	19°	38`	30.96``E
6	40°	9`	13.15``N	19°	38`	32.12``E
7	40°	9`	12.86``N	19°	38`	34.12``E
8	40°	9`	11.79``N	19°	38`	35.98``E
9	40°	9`	10.18``N	19°	38`	35.34``E
10	40°	9`	9.81``N	19°	38`	34.63``E
11	40°	9`	7.10``N	19°	38`	34.36``E
12	40°	9`	5.88``N	19°	38`	33.68``E
13	40°	9`	6.42``N	19°	38`	29.45``E
14	40°	9`	6.42``N	19°	38`	29.45``E
15	40°	9`	6.95``N	19°	38`	28.02``E

16	40°	9`	4.74``N	19°	38`	27.42``E
17	40°	9`	2.89``N	19°	38`	24.72``E
18	40°	9`	2.19``N	19°	38`	23.40``E
19	40°	9`	3.06``N	19°	38`	19.20``E
20	40°	9`	3.90``N	19°	38`	17.48``E
21	40°	9`	5.00``N	19°	38`	15.95``E
22	40°	9`	6.33``N	19°	38`	16.03``E
23	40°	9`	7.59``N	19°	38`	16.53``E
24	40°	9`	8.70``N	19°	38`	18.25``E
25	40°	9`	10.09``N	19°	38`	19.33``E
26	40°	9`	11.29``N	19°	38`	20.35``E
27	40°	9`	11.93``N	19°	38`	21.46``E
28	40°	9`	11.95``N	19°	38`	22.63``E
29	40°	9`	13.07``N	19°	38`	23.24``E
30	40°	9`	13.69``N	19°	38`	22.51``E
31	40°	9`	14.95``N	19°	38`	22.42``E
32	40°	9`	16.03``N	19°	38`	22.64``E

ZONA E MBROJTUR DHËRMI						
1	40°	9`	9.02``N	19°	38`	5.91``E
2	40°	9`	9.85``N	19°	38`	6.64``E
3	40°	9`	11.51``N	19°	38`	7.07``E
4	40°	9`	13.11``N	19°	38`	7.01``E
5	40°	9`	14.33``N	19°	38`	6.68``E
6	40°	9`	14.71``N	19°	38`	8.16``E
7	40°	9`	15.98``N	19°	38`	9.44``E
8	40°	9`	16.42``N	19°	38`	9.61``E
9	40°	9`	17.15``N	19°	38`	9.43``E
10	40°	9`	17.40``N	19°	38`	10.20``E
11	40°	9`	18.28``N	19°	38`	11.57``E
12	40°	9`	19.17``N	19°	38`	13.64``E
13	40°	9`	20.26``N	19°	38`	16.50``E
14	40°	9`	21.74``N	19°	38`	20.81``E
15	40°	9`	21.21``N	19°	38`	24.07``E
16	40°	9`	18.30``N	19°	38`	26.71``E
17	40°	9`	17.51``N	19°	38`	28.98``E
18	40°	9`	15.91``N	19°	38`	31.03``E
19	40°	9`	13.84``N	19°	38`	32.63``E
20	40°	9`	13.34``N	19°	38`	34.18``E
21	40°	9`	11.94``N	19°	38`	36.52``E
22	40°	9`	10.12``N	19°	38`	37.05``E
23	40°	9`	8.27``N	19°	38`	37.05``E
24	40°	9`	7.22``N	19°	38`	41.37``E
25	40°	9`	7.61``N	19°	38`	43.45``E
26	40°	9`	6.65``N	19°	38`	43.94``E
27	40°	9`	6.41``N	19°	38`	44.73``E
28	40°	9`	5.15``N	19°	38`	44.04``E
29	40°	9`	3.98``N	19°	38`	43.65``E
30	40°	9`	1.97``N	19°	38`	42.51``E
31	40°	9`	0.56``N	19°	38`	42.95``E
32	40°	8`	58.15``N	19°	38`	43.24``E
33	40°	8`	57.14``N	19°	38`	44.27``E
34	40°	8`	54.07``N	19°	38`	42.12``E
35	40°	8`	49.73``N	19°	38`	37.04``E
36	40°	8`	50.12``N	19°	38`	35.75``E
37	40°	8`	47.41``N	19°	38`	31.25``E
38	40°	8`	44.41``N	19°	38`	26.20``E
39	40°	8`	45.96``N	19°	38`	22.13``E
40	40°	8`	48.85``N	19°	38`	17.63``E
41	40°	8`	49.30``N	19°	38`	17.90``E
42	40°	8`	50.55``N	19°	38`	17.46``E
43	40°	8`	53.56``N	19°	38`	20.15``E

44	40°	8`	54.15``N	19°	38`	19.74``E
45	40°	8`	53.97``N	19°	38`	17.41``E
46	40°	8`	55.50``N	19°	38`	15.97``E
47	40°	8`	57.83``N	19°	38`	15.71``E
48	40°	9`	0.17``N	19°	38`	15.80``E
49	40°	9`	1.81``N	19°	38`	14.89``E
50	40°	9`	3.64``N	19°	38`	13.65``E
51	40°	9`	5.47``N	19°	38`	13.88``E
52	40°	9`	7.13``N	19°	38`	14.64``E
53	40°	9`	7.87``N	19°	38`	13.92``E
54	40°	9`	7.83``N	19°	38`	10.06``E
55	40°	9`	7.35``N	19°	38`	9.21``E
56	40°	9`	7.97``N	19°	38`	7.34``E

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT DHËRMI DHE ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) administrimi i Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;

b) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi.

3. Kjo rregullore përcakton edhe mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Himarës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Dhërmi për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje e fshatit Dhërmi përbëhet nga:

a) Qendra Historike;

b) Zona e Mbrojtur rreth saj.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj paraqiten në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

4. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë së Himarës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 3
Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit Dhërmi. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik tradicional i cili është pjesë e Qendrës Historike. Qendra Historike përbëhet edhe nga zonat e gjelbra të përfshira brenda saj.

2. Qendra Historike e fshatit Dhërmi përbëhet nga dy zona:

a) Zona I e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës kombëtare në hyrje të fshatit Dhërmi;

b) Zona II e cila përfshin pjesën e Dhërmiut të vjetër dhe shtrihet në pjesën verilindore deri mbi rrënojat e Manastirit të Panaisë me Kishën e Fjetjes së Shën Mërisë dhe në jugperëndim zbret deri poshtë rrugës kombëtare.

Në këto zona përfshihen një numër i konsiderueshëm banesash me një tipologji të larmishme dhe një rrjet rrugor të kalldrëmuar, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësi të terrenit.

3. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten në koordinata gjeografike si edhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

1. Ndërhyrjet restauruese dhe rigjallëruese në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive do të kenë si qëllim kthimin e fshatit Dhërmi në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar. Për të realizuar këtë qëllim për Qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rigjallëruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.

b) Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.

c) Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike.

ç) Studime të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

d) Ndërhyrjet rehabilituese, konservuese ose restaurimet integruese, për ndërtimet që janë në gjendje rrënoje për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3 m ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen duke zbatuar parimet e mësipërme.

Projektet për ndërhyrjet në këto lloj objektesh do të shqyrtohen dhe do të miratohen rast pas rasti në Këshillin Shkencor dhe Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

dh) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

e) Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje, si trajtimi i tyre me materiale të traditës dhe zonës, dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

3. Në Qendrën Historike ndalohen ndërtimet e reja me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

4. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 5

Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e Mbrojtur shtrihet në pjesën më të madhe në anën juglindore të Qendrës Historike. Ajo përbëhet nga:

a) Nënzona I e mbrojtur;

b) Nënzona II e mbrojtur (Zonë e Gjelbër).

2. Nënzona I e mbrojtur përmban banesa me vlera arkitektonike dhe rrjetin rrugor karakteristik të fshatit, me të cilat plotësohen vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të planifikuara për ndërtime të reja.

3. Nënzona II e mbrojtur është një zonë me një gjelbërim që formohet nga drurë të ndryshëm, si me ullinj, rrepër dhe bimësi të ndryshme që ndan edhe dy pjesët e Qendrës Historike dhe përbën pjesën më të madhe të zonës së gjelbër të fshatit.

4. Kufijtë e Zonës së Mbrojtur paraqiten në koordinatat gjeografike, si dhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6
Ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur

1. Ndërhyrjet që lejohen në Zonën e Mbrojtur janë si më poshtë:

a) Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përveç rikonstruksionit të tij.

b) Kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

c) Ruajtja e rrjetit rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

ç) Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale.

3. Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 2 (dy) – 6.5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit.

4. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

5. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 7
Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e Kulturës në fshatin Dhërmi, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore, ndahen në dy kategori:

a) Monumente të kategorisë I;

b) Monumente të kategorisë II.

2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur ose në pjesët e tjera të fshatit. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat e shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Neni 8
Monumentet e kategorisë I

1. Monumentet e kategorisë I janë objektet dhe ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale të fshatit Dhërmi.

2. Monumentet e kategorisë I, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe si të tilla i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

3. Monumentet e kategorisë I, ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur rreth saj dhe në pjesën tjetër të fshatit.

4. Në monumentet e kategorisë I, kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

5. Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve të kategorisë I, që ndodhen jashtë

zonës së Qendrës Historike, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës. Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve rast pas rasti.

Neni 9
Monumentet e kategorisë II

1. Monumentet e kategorisë II, janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme dhe të brendshme në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë. Këto ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë II lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme, si dhe për t'u adaptuar edhe për shërbime të tjera.

Neni 10
Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike të fshatit Dhërmi dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Për monumentet e kulturës, pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në shkronjat "c", "d", "e" dhe "f", të pikës 2, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 11
Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Bashkinë Himarë ose subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas kësaj rregulloreje. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e

ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjektet ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

5. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës ose nga subjekte të licencuara në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 12

Zonat e gjelbëruara brenda Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur përreth saj

1. Zonat e gjelbëruara janë pjesë përbërëse e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur, kanë destinacion publik dhe janë elemente që u shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbëruara ruhen si të tilla.

2. Në këto zona lejohen ndërhyrje për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese si dhe mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e rrugicave të brendshme me karakteristika të njëjta, si të kalldrëmeve origjinale të Qendrës Historike, të cilat do të përdoren vetëm për këmbësorë.

3. Në këto zona janë të ndaluara ndërtimet me përjashtim të strukturave të elementëve të arredimit urban ose ato të shërbimit. Projektet për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara hartohen nga Bashkia Himarë ose nga subjekte të licencuara për këtë kategori punimesh.

4. Drurët dhe gjelbërimi tradicional i rrugëve dhe shesheve ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Neni 13

Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 14

Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritur në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plani i përgjithshëm vendor i Himarës detyrimisht merr parasysh vlerat e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 16

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

3. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë i paraqet për shqyrtim dhe miratim ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës të kategorive I dhe II.



VENDIM
Nr. 30, datë 20.1.2016

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT VUNO DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Vuno, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores "Për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe të Zonës së Mbrojtur përreth", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËR SHPALLJEN QENDËR HISTORIKE TË VUNOIT, HIMARË
KORDINATAT GJEOGRAFIKE

	Gjatësi			Gjerësi		
Pika	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
QENDËR HISTORIKE 1						
1	40°	8`	25.41``N	19°	41`	30.05``E
2	40°	8`	26.60``N	19°	41`	30.44``E
3	40°	8`	27.08``N	19°	41`	29.86``E
4	40°	8`	28.25``N	19°	41`	29.86``E
5	40°	8`	30.51``N	19°	41`	31.74``E
6	40°	8`	31.47``N	19°	41`	34.50``E
7	40°	8`	32.36``N	19°	41`	36.34``E
8	40°	8`	32.34``N	19°	41`	37.95``E
9	40°	8`	31.80``N	19°	41`	37.73``E
10	40°	8`	31.54``N	19°	41`	38.34``E
11	40°	8`	32.24``N	19°	41`	39.55``E
12	40°	8`	32.45``N	19°	41`	40.98``E
13	40°	8`	32.25``N	19°	41`	43.42``E
14	40°	8`	31.72``N	19°	41`	44.98``E
15	40°	8`	30.58``N	19°	41`	46.33``E
16	40°	8`	29.87``N	19°	41`	46.70``E
17	40°	8`	29.06``N	19°	41`	46.08``E
18	40°	8`	28.49``N	19°	41`	47.23``E
19	40°	8`	27.38``N	19°	41`	44.80``E
20	40°	8`	26.03``N	19°	41`	43.29``E
21	40°	8`	25.29``N	19°	41`	43.03``E
22	40°	8`	23.75``N	19°	41`	42.80``E
23	40°	8`	22.43``N	19°	41`	432.61``E
24	40°	8`	20.68``N	19°	41`	41.28``E
25	40°	8`	20.14``N	19°	41`	39.80``E
26	40°	8`	20.87``N	19°	41`	38.36``E
27	40°	8`	21.69``N	19°	41`	38.42``E
28	40°	8`	22.00``N	19°	41`	37.00``E
29	40°	8`	22.54``N	19°	41`	35.45``E
30	40°	8`	23.43``N	19°	41`	35.26``E
31	40°	8`	23.84``N	19°	41`	34.47``E

32	40°	8`	24.33``N	19°	41`	34.80``E
33	40°	8`	24.59``N	19°	41`	36.36``E
34	40°	8`	25.86``N	19°	41`	36.04``E
35	40°	8`	25.51``N	19°	41`	34.19``E
36	40°	8`	25.08``N	19°	41`	32.26``E
QENDËR HISTORIKE 2						
1	40°	8`	16.64``N	19°	41`	41.20``E
2	40°	8`	16.98``N	19°	41`	42.12``E
3	40°	8`	18.64``N	19°	41`	41.54``E
4	40°	8`	19.56``N	19°	41`	42.98``E
5	40°	8`	20.11``N	19°	41`	44.12``E
6	40°	8`	19.12``N	19°	41`	45.35``E
7	40°	8`	17.51``N	19°	41`	45.25``E
8	40°	8`	16.80``N	19°	41`	45.42``E
9	40°	8`	16.58``N	19°	41`	44.38``E
10	40°	8`	16.42``N	19°	41`	42.73``E
11	40°	8`	15.84``N	19°	41`	42.40``E
12	40°	8`	15.73``N	19°	41`	41.72``E

ZONA E MBROJTUR VUNO						
1	40°	8`	26.68``N	19°	41`	22.49``E
2	40°	8`	27.22``N	19°	41`	24.46``E
3	40°	8`	27.07``N	19°	41`	27.83``E
4	40°	8`	29.20``N	19°	41`	28.75``E
5	40°	8`	31.06``N	19°	41`	28.99``E
6	40°	8`	33.65``N	19°	41`	33.99``E
7	40°	8`	33.61``N	19°	41`	38.82``E
8	40°	8`	33.41``N	19°	41`	44.99``E
9	40°	8`	31.21``N	19°	41`	48.02``E
10	40°	8`	28.23``N	19°	41`	47.76``E
11	40°	8`	26.52``N	19°	41`	48.02``E
12	40°	8`	23.49``N	19°	41`	49.96``E
13	40°	8`	19.76``N	19°	41`	48.94``E
14	40°	8`	17.04``N	19°	41`	49.19``E
15	40°	8`	16.33``N	19°	41`	48.28``E
16	40°	8`	16.86``N	19°	41`	46.75``E
17	40°	8`	16.68``N	19°	41`	45.06``E
18	40°	8`	16.35``N	19°	41`	43.63``E
19	40°	8`	15.39``N	19°	41`	41.60``E
20	40°	8`	14.06``N	19°	41`	41.37``E
21	40°	8`	14.95``N	19°	41`	38.92``E
22	40°	8`	15.03``N	19°	41`	36.72``E
23	40°	8`	14.95``N	19°	41`	34.63``E
24	40°	8`	15.96``N	19°	41`	33.76``E
25	40°	8`	15.94``N	19°	41`	31.67``E
26	40°	8`	17.03``N	19°	41`	30.83``E
27	40°	8`	16.92``N	19°	41`	29.35``E
28	40°	8`	18.30``N	19°	41`	29.51``E
29	40°	8`	19.20``N	19°	41`	29.08``E
30	40°	8``	19.87``N	19°	41`	27.71``E
31	40°	8`	20.64``N	19°	41`	25.35``E
32	40°	8`	21.84``N	19°	41`	24.57``E
33	40°	8`	25.44``N	19°	41`	23.44``E
34	40°	8`	25.76``N	19°	41`	22.25``E

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT VUNO E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe të Zonës së Mbrojtur rreth saj.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) administrimi i Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, si pjesë përbërëse e saj;

b) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Vuno.

3. Kjo rregullore përcakton edhe mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Himarës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të fshatit Vuno.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Vuno, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore, i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje e fshatit Vuno përbëhet nga:

a) Qendra Historike;

b) Zona e Mbrojtur rreth saj.

3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

4. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Himarës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 3
Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit Vuno. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik, tradicional, i cili është pjesë e Qendrës Historike.

2. Qendra Historike përbëhet edhe nga zonat e gjelbra të përfshira brenda saj.

3. Qendra Historike e fshatit Vuno përbëhet nga dy zona:

a) Zona I e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës kombëtare (kryesisht Vunoi i vjetër);

b) Zona II e cila përfshin pjesën që ndodhet poshtë rrugës kombëtare që përbëhet nga kompleksi i Kishës së Shën Spiridhonit së bashku me shkollën dhe Kishën e Shën Mehillit. Në këto zona përfshihen një numër i konsiderueshëm banesash me një tipologji të larmishme dhe një rrjet rrugor të shtruar me kalldrëm, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësitë e terrenit dhe vende-vende me kalime në formë tuneli nën banesat e fshatit.

4. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten me koordinata gjeografike si edhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 4
Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

1. Ndërhyrjet restauruese dhe rigjallëruese në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive do të kenë si qëllim kthimin e fshatit Vuno në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar. Për të realizuar këtë qëllim, për Qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rigjallëruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike të fshatit Vuno, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja

kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.

b) Ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese e të bimësisë tradicionale.

c) Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike.

ç) Studimet përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

d) Ndërhyrjet rehabilituese në shumë ndërtime në gjendje rrënoje konservuese ose restaurimet integruese për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3 m, ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen, duke zbatuar parimet e mësipërme.

Projektet për ndërhyrjet në këto lloj objektesh do të shqyrtohen dhe do të miratohen rast pas rasti në Këshillin Shkencor dhe Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

dh) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

e) Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

3. Në Qendrën Historike ndalohen ndërtimet e reja me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikën 2, të këtij neni.

4. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet e restaurimet miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e Mbrojtur rrethon pjesën e Qendrës Historike dhe shtrihet në jugperëndim dhe juglindje të saj në pjesën më të madhe, ndërsa në pjesën veriore ajo krijon një brez mbrojtës për Qendrën Historike mbi kufirin e fshatit ekzistues.

2. Zona e Mbrojtur përfshin disa banesa me vlera arkitektonike, rrjetin rrugor karakteristik të fshatit të shtruar me kalldrëm dhe disa objekte kulti të një rëndësie të veçantë, me të cilat plotëson vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të planifikuara për ndërtime të reja.

3. Kufijtë e Zonës së Mbrojtur paraqiten me koordinatat gjeografike si dhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur

1. Ndërhyrjet që lejohen në Zonën e Mbrojtur janë, si më poshtë vijon:

a) Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues, përveç rikonstruksionit të tij.

b) Kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

c) Ruajtja e rrjetit rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

ç) Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale.

2. Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 2 (dy) – 6.5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

4. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 7

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e Kulturës në fshatin Vuno, sipas vlerave të tyre historiko – kulturore, ndahen në dy kategori:

a) Monumente të kategorisë I;

b) Monumente të kategorisë II.

2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur ose në pjesët e tjera të fshatit. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat e në shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Neni 8

Monumentet e kategorisë I

1. Monumentet e kategorisë I janë objektet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale të fshatit Vuno.

2. Monumentet e kategorisë I, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

3. Monumentet e kategorisë I ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur rreth saj dhe në pjesën tjetër të fshatit.

4. Në monumentet e kategorisë I kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

5. Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve të kategorisë I nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës.

Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, rast pas rasti.

Neni 9

Monumentet e kategorisë II

1. Monumentet e kategorisë II janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme e të brendshme në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë. Këto ruhen dhe i

nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë II lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme, si dhe për t'u adaptuar edhe për shërbime të tjera.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Për monumentet e kulturës, pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në shkronjat "c", "d", "e" dhe "f", të pikës 2, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës, ose nga persona të licencuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në zonën e mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Bashkinë Himarë ose subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre të përmendura në nenin 6 hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të

Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 12
Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 13
Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plani rregullues i fshatit Vuno, detyrimisht, merr parasysh vlerat e Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 15
Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

3. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë, i paraqet për shqyrtim dhe miratim ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës të kategorive I dhe II.

QENDRA HISTORIKE VUNO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MIRATOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Z. EDI RAMA

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTËR

Znj. MIRELA KUMBARO

INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURËS

DREJTOR

Znj. ARTA DOLLANI

Miratuar me Vendim të KKR Nr. __, Datë __/__/____

LEGJENDË:

KUFI I QENDRËS HISTORIKE

KUFI I ZONËS SË MBROJTUR

MONUMENT KULTURE KATI

VENDIM
Nr. 32, datë 20.1.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1555, DATË 12.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË REGJISTRIMIT DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 9362, datë 24.3.2005, "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1555, datë 12.11.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 5, të kreut I, shtohet pika 5.41, me këtë përmbajtje:

"5.41. "Prodhim i PMB-ve", prodhimi dhe/ose ambalazhimi i tyre. Veprimtaria e prodhimit të PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5.A.1. dhe licencohet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.".

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "a", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve në ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë, i cili kryeson këtë komision.".

b) Pika 2.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.3 Komisioni shërben si organ vendimmarrës, funksionimi i të cilit rregullohet me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë. Kryetar i komisionit caktohet drejtuesi i SPMB-së.".

c) Pika 7.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7.1 Është e regjistruar:

a) në një shtet anëtar të BE-së, kur aplikimi i regjistrimit të PMB-së bëhet vetëm për:

i) përdorim në sera;

ii) trajtim pas vjeljes së bimëve e të produkteve me origjinë bimore;

iii) trajtim të mjediseve bosh të mbyllura, si dhomave, magazinave etj.;

iv) trajtim të farave;

v) rastet kur ka funksion rodenticid ose moluskicid;

vi) rastet kur është me përmbajtje vajrash të bardha;

vii) rastet kur është me natyrë inorganike.

b) në një nga shtetet mesdhetare dhe ballkanike, anëtare të BE-së, si: Greqia, Qipro, Italia, Kroacia, Sllovenia, Franca, Spanja, Portugalia, Malta, Rumania dhe Bullgaria, kur aplikimi i regjistrimit të PMB-së bëhet për përdorime të tjera, përfshirë dhe ato sipas shkronjës "a", më sipër.

3. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Nënndarja "ii", e shkronjës "b", të pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. Të dhënat që provojnë se PMB-ja është e regjistruar në një shtet anëtar të BE-së (Certifikatën e regjistrimit ose vërtetimin e lëshuar nga institucionet zyrtare kompetente dhe numrin e regjistrimit sipas adresës elektronike të shtetit që ka regjistruar PMB-në) si dhe etiketën përkatëse. Etiketa të jetë e përkthyer dhe në gjuhën shqipe.".

b) Në fund të pikës 16 shtohen fjalët "…, ose vërtetohet se të dhënat e regjistrimit të PMB-së në një shtet anëtar të BE-së janë false ose të gabuara.".

4. Në kreun V bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1.Dokumenti i regjistrimit të PMB-së përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën e saj. Dokumenti i regjistrimit të PMB-së lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e mbledhjes së KSHRPMB-së.

Dokumenti i regjistrimit të PMB-së mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra mbahet në arkivin e ministrisë që mbulon fushën e

bujqësisë, njëra në arkivin e SPMB-së, ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.".

b) Në fund të fjalisë së parë të pikës 3 shtohen fjalët "., ose figura të bimëve, pjesëve të bimëve, produkteve bimore, insekteve si dhe objekteve të tjera, të cilat tërheqin vëmendjen e njerëzve dhe sidomos të fëmijëve.".

c) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Çdo person fizik apo juridik i regjistruar në QKR dhe që kërkon të licencohet për prodhimin e PMB-ve duhet të plotësojë dokumentacionin si vijon:

a) Vetëdeklarimin për llojet (tipat) e formulimit të PMB-ve që do të prodhohen;

b)Planimetrinë në shkallën 1:100 me një përshkrim të detajuar të ambienteve si dhe të treguesve të destinacionit të përdorimit të tyre;

c) Raportin teknik-përshkrues për:

i) vendndodhjen e aktivitetit;

ii) llojin e pajisjeve dhe të teknologjive të prodhimit;

iii) aparaturat (laboratorin) e kontrollit dhe të analizave (nëse aktiviteti është vetëm prodhim dhe jo ambalazhim i PMB-ve);

iv) sistemet e sigurisë.

ç) Certifikatën e drejtuesit teknik dhe aktin që vërteton marrëdhëniet e kërkuara të punës.

12.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit verifikon plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 12, të certifikuar nga organet përkatëse kompetente për pajtueshmërinë e tyre me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi.

12.2. Drejtuesi teknik:

a) ushtron aktivitetin e tij bazuar në kontratën e punës me orar të plotë;

b)duhet të zotërojë diplomë në një prej fushave: kimi, inxhinieri e teknologjisë, agronomi, nëse aktiviteti i tij është vetëm ambalazhim, dhe shkencat biologjike, nëse aktiviteti i tij përfshin PMB-të me natyrë biologjike;

c) ka për detyrë të ndjekë dhe të kontrollojë të gjitha fazat e procesit të prodhimit të PMB-ve.

12.3 Lejohet vetëm prodhimi i PMB-ve që janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

12.4 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës me kërkesë të subjektit apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat sipas legjislacionit në fuqi.

12.4.1 Kundër vendimit për pezullimin e përkohshëm të licencës mund të bëhet ankimim te titullari i AKU-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendit. Titullari i AKU-së duhet të kthejë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimimit. Kundër vendimit të titullarit të AKU-së ose kur ai nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar mund të bëhet ankimim në gjykatën administrative sipas legjislacionit në fuqi.

12.4.2. Kundër vendimit për revokimin e licencës mund të bëhet ankimim te ministri, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendit. Ministri duhet të kthejë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimimit. Kundër vendimit të ministrit ose kur ai nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar mund të bëhet ankimim në gjykatën administrative sipas legjislacionit në fuqi.".

5. Pika 9, e kreut VI, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Kur mbaron afati i regjistrimit të një PMB-je, mund të kryhet rinovimi i regjistrimit (riregjistrimi) të saj, nëse:

a) kjo kërkohet me shkrim nga aplikanti para përfundimit të afatit të regjistrimit;

b) aplikanti paraqet:

i) dokumentacionin me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS);

ii) të dhëna të tjera lidhur me etiketën e saj, nëse ka ndryshime nga regjistrimi i mëparshëm.

c) të dhënat e paraqitura nga aplikanti që provojnë vlefshmërinë e regjistrimit në një vend të BE-së, sipas përcaktimit në pikën 4, të këtij vendimi.

Rinovimi i regjistrimit kryhet me procedurë të thjeshtë, me miratim nga KSHRPMB-ja.".

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 34, datë 20.1.2016

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 871 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG), PROJEKTIT "INNOVATION HUB"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 871 (tetëqind e shtatëdhjetë e një) m², të mjediseve të katit të dytë të ndërtesës "Godina e Inovacionit", me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga "Papa Gjon Pali", nr. 3, në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), projektit "Innovation Hub" për një afat prej 3 vitesh, sipas planimetrisë dhënë në aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që të lidhë aktmarrëveshje me projektin "Innovation Hub", për marrjen përsipër nga ASIG-u të mbulimit të shpenzimeve për shërbimet e nevojshme, që i nevojiten projektit "Innovation Hub", në këto ambiente.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 35, datë 20.1.2016

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1/2, të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen emërtesat: Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Shkodër, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Tiranë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Korçë, Agjencia për Zhvillimin Rajonal me qendër në Vlorë, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER).

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga data 1 janar 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 37, datë 21.1.2016

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT E REGJISTRUAR SI TË VETËPUNËSUAR, TË CILËT KRYEJNË VEPRIMTARI EKONOMIKE PROFESIONALE DHE PUNONJËSIT E PAPAGUAR TË FAMILJES QË PUNOJNË E BASHKËJETOJNË ME TË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi janë personat e regjistruar si person fizik, me ose pa të punësuar, si dhe me ose pa punonjës të papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike në një ose disa nga profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagat mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar në profesionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, përcaktohen në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në

përcaktimin e këtyre pagave mbahen parasysh lloji i veprimtarisë profesionale, zona ku ajo zhvillohet, vitet e punës në profesion, numri i të punësuarve, paga për të njëjtin profesion në sektorin publik, vitet e punës në bazë të licencës në profesion dhe statusi i profesionit.

3. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, kategorizimi i bashkive dhe zonave ku zhvillohet veprimtaria është sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Paga mujore sipas llojit të profesionit, objekt i këtij vendimi, përbën kufirin minimal të pagës për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këto paga vetëdeklarohen nga tatimpaguesi përkatës dhe, kur administrata tatimore vëren se pagat e deklaruara për efekt të llogaritjes së kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë më të vogla nga paga respektive e përcaktuar në këtë vendim, ajo ka autoritetin t'i rivlerësojë, sipas nivelit të pagës përkatëse të përcaktuar në këtë vendim.

5. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët punojnë në profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, llogaritet ne bazë të pagës minimale sipas vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

6. Kur ndonjë nga veprimtaritë profesionale, të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, kryhet nga persona që kanë edhe të punësuar ose edhe anëtarë të papaguar, paga mujore për të vetëpunësuarin sipas pikës 1, të këtij vendimi, e përcaktuar në aneksin nr. 2, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shtohet me 3 për qind për çdo të punësuar ose anëtar familje me kohë të plotë dhe 2 për qind për çdo të punësuar me kohë të pjesshme, por jo më shumë se paga maksimale.

7. Kur ndonjë nga veprimtaritë profesionale të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi kryhen nga persona që fillojnë veprimtarinë ekonomike profesionale për herë të parë, paga mujore e përcaktuar në tabelë, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në tri vitet e para kalendarike të ushtrimit të profesionit me leje/licencë, zbritet me 30 për qind të pagës sipas aneksit nr. 2, ndërsa për tri vitet e tjera kalendarike të ushtrimit të veprimtarisë me leje/licencë zbritet me 15 për qind të pagës sipas aneksit nr. 2, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

8. Kur veprimtaritë profesionale të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi kryhen nga persona që janë edhe të punësuar ose kryejnë edhe aktivitete të tjera vetëpunësimi, paga mujore e përcaktuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi, por me kusht që shuma e pagave nga të gjitha veprimtaritë të mos kalojë nivelin e pagës maksimale, vetëm për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore.

9. Mbështetur në pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pensionistët e regjistruar si persona fizikë të vetëpunësuar të vetëm, që punojnë në profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, nuk kanë detyrim për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në raste të tjera, paguajnë kontribut në nivelin minimal sipas përcaktimeve të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

10. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1. Lista e profesioneve

Nr.	Profesioni
1	Farmacist
2	Programues IT (programues te aplikacioneve/zhvillues *software*) aktivitete të programimit informatik
3	Vlerësues i pasurisë
4	Avokat
5	Noter
6	Përmbarues
7	Konsulent/këshillues në fushën ekonomike, fiskut, sigurimeve, si: kontabilist, ekonomist, jurist, inxhinier, këshillues fiskal dhe profesione të fushave të tjera
8	Ekspert kontabël i regjistruar
9	Kontabilist i miratuar
10	Arkitektit
11	Inxhinier
12	Projektues
13	Agronom
14	Përkthyes
15	Shoqërues dhe shpjegues në udhëtime
16	Veteriner
17	Mësues (mësimdhënës)
18	Trajnues në veprimtari të ndryshme përfshirë edhe fushën e kulturës, artit dhe sportit
19	Mjek i përgjithshëm
20	Mjek i specializuar
21	Dentist i specializuar dhe dentist
22	Fizioterapist
23	Ndërmjetës në një proces gjyqësor

Aneksi 2. Aktivitete, profesionet dhe pagat referuese

Seksioni	Ndarja	Grupi	Klasa	Emërtimi i vep. Ekonom.	Profesioni	Kategoria e qendrave të bashkive, ku zhvillohet biznesi					Zona rurale e bashkisë përkatëse
						I	II	III	IV	V	
G	47	47.7	47.73	Shitja e artikujve farmaceutikë	Farmacist	57,500	57,500	53,475	50,600	47,725	40,250
J	62	62.0	62.01	Aktivitete të programimit informatik	Programues IT (programues të aplikacioneve/zhvillues *software*) aktivitete të programimit informatik	88,800	70,100	65,193	61,688	58,183	
L	68	68.3	68.32	Shërbime të vlerësimit të pasurive të paluajtshme	Vlerësues i pasurisë	73,800	62,600	58,218	55,088		
M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Avokat	73,800	73,800	68,634	64,944	61,254	
M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Noter	73,800	73,800	68,634	64,944	61,254	
M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Përmbarues	62,600	52,300	48,639	46,024		

M	69	69.1	69.10	Aktivitete juridike (ligjore)	Ndërmjetës në një proces gjyqësor	62,600	52,300	48,639	46,024		
M	69	69.2-70.2	69.2-70.22	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Konsulent/këshillues në fushën ekonomike, fiskut, sigurimeve, si kontabilist, ekonomist, jurist, inxhinier, këshillues fiskal dhe profesione të fushave të tjera.	73,800	62,600	58,218	55,088		
M	69	69.2	69.20	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Ekspert kontabël i regjistruar	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	69	69.2	69.20	Aktivitete të llogarive dhe konsulencës	Kontabilist i miratuar	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Arkitektit	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Inxhinier	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	Projektues	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	74	74.9	74.90	Të tjera aktivitete prof. shkenc. teknik	Agronom	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820
M	74	74.3	74.30	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi	Përkthyes	62,600	62,600	58,218	55,088		
M	74	74.3	74.30	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi	Shoqërues dhe shpjegues në udhëtime	52,300	52,300	48,639	46,024		
M	75	75.0	75.00	Aktivitete veterinare	Veteriner	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820
P	85			Arsimi	Mësues (mësimdhënës)	58,100	55,100	51,243	48,488	45,733	41,325
P	85			Arsimi	Trajnues në veprimtari të ndryshme përfshirë edhe fushën e kulturës, artit dhe sportit.	62,600	52,300	48,639	46,024	43,409	
Q	86	86.2	86.21	Aktivitete të mjekëve të përgjithshëm	Mjek i përgjithshëm	65,000	55,000	51,150	48,400	45,650	41,250
Q	86	86.2	86.22	Aktivitete të mjekëve të specializuar	Mjek i specializuar	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	
Q	86	86.2	86.23	Aktivitete të dentistëve	Dentist i specializuar dhe dentist	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	45,000
Q	86	86.9	86.90	Shërbime të tjera shëndetësore e kurative": fizioterapi, qendra estetike ku afrohet shërbim mjekësor, qendra të trajtimit të vartësisë nga droga, qendra balneare, të kujdesit paliativ dhe të tjera	Fizioterapist	66,100	56,100	52,173	49,368		

Shënim. Kur kryhen aktivitet profesionale në qendrat e bashkive të ndara në kategorinë V ose në zonën rurale të bashkive përkatëse dhe në tabelë nuk ka pagë të përcaktuar, si pagë referuese merret paga e përcaktuar në kategorinë IV, për profesionin përkatës.

Aneksi 3. Kategoria e qendrave të bashkive ku zhvillohet biznesi

			Kategoria e qendrave të bashkive, ku zhvillohet biznesi					
Bashkia	**Qarku**	**Qendra e bashkisë**	**I**	**II**	**III**	**IV**	**V**	**Zona rurale e bashkisë përkatëse**
38. Pustec	Korçë	Pustec					x	x
29. Libohovë	Gjirokastër	Libohovë					x	x
45. Fushë-Arrëz	Shkodër	Fushe-Arrëz					x	x
28. Këlcyrë	Gjirokastër	Këlcyrë					x	x
58. Konispol	Vlorë	Konispol					x	x
32. Tepelenë	Gjirokastër	Tepelenë				x		x
3. Poliçan	Berat	Poliçan					x	x
8. Klos	Dibër	Klos					x	x
39. Has	Kukës	Krume					x	x
55. Delvinë	Vlorë	Delvinë					x	x
4. Skrapar	Berat	Çorovodë				x		x
30. Memaliaj	Gjirokastër	Memaliaj					x	x
31. Përmet	Gjirokastër	Përmet				x		x
34. Kolonjë	Korçë	Ersekë				x		x
26. Dropull	Gjirokastër	Jergucat						x
41. Tropojë	Kukës	B. Curri				x		x
57. Himarë	Vlorë	Himarë				x		x
25. Roskovec	Fier	Roskovec						x
13. Belsh	Elbasan	Belsh					x	x
19. Përrenjas	Elbasan	Përrenjas					x	x
54. Vorë	Tiranë	Vorë				x		x
60. Selenicë	Vlorë	Selenice					x	x
18. Peqin	Elbasan	Peqin					x	x
44. Mirditë	Lezhë	Rrëshen				x		x
5. Ura Vajgurore	Berat	Ura Vajgurore					x	x
6. Bulqizë	Dibër	Bulqizë				x		x
9. Mat	Dibër	Burrel				x		x
16. Gramsh	Elbasan	Gramsh				x		x
56. Finiq	Vlorë	Finiq					x	x
52. Rrogozhinë	Tiranë	Rrogozhinë					x	x
17. Librazhd	Elbasan	Librazhd				x		x
12. Shijak	Durrës	Shijak				x		x
23. Mallakastër	Fier	Ballsh				x		x
24. Patos	Fier	Patos				x		x
33. Devoll	Korçë	Bilisht				x		x
14. Cërrik	Elbasan	Cërrik					x	x
49. Vau i Dejës	Shkodër	Vau i Dejës					x	x
20. Divjakë	Fier	Divjakë					x	x
27. Gjirokastër	Gjirokastër	Gjirokastër			x			x
46. Malësi e Madhe	Shkodër	Koplik					x	x
47. Pukë	Shkodër	Pukë				x		x

1. Berat	Berat	Berat			x			x
2. Kuçovë	Berat	Kuçovë				x		x
40. Kukës	Kukës	Kukës			x			x
59. Sarandë	Vlorë	Sarandë			x			x
36. Maliq	Korçë	Maliq					x	x
42. Kurbin	Lezhë	Laç				x		x
7. Dibër	Dibër	Peshkopi			x			x
11. Krujë	Durrës	Krujë				x		x
51. Kavajë	Tiranë	Kavajë			x			x
43. Lezhë	Lezhë	Lezhë			x			x
37. Pogradec	Korçë	Pogradec			x			x
50. Kamzë	Tiranë	Kamzë				x		x
22. Lushnjë	Fier	Lushnjë			x			x
35. Korçë	Korçë	Korçë		x				x
61. Vlorë	Vlorë	Vlorë		x				x
21. Fier	Fier	Fier		x				x
48. Shkodër	Shkodër	Shkodër		x				x
15. Elbasan	Elbasan	Elbasan		x				x
10. Durrës	Durrës	Durrës		x				x
53. Tiranë	Tiranë	Tiranë	x					x

Shënim. Kur vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike profesionale, nga profesionet e mësipërme, kryhen në fshatra në juridiksionet sipas bashkive, paga referuese zbritet me 20 % por jo më pak se paga minimale në shkallë vendi.

VENDIM
Nr. 38, datë 21.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT "PËR AKCIZAT"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Paragrafi i dytë, i nënndarjes "iii", të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 43, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Karta teknologjike duhet të jetë e konfirmuar/e certifikuar nga një institucion/ent/organizëm publik shtetëror ose privat që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike dhe që shërbimin e konfirmimit/certifikimit të kartave teknologjike e ka të akreditуar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose ka statusin e Organit të Miratuar të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) për shërbimin e ofruar.".

Neni 2

Në nenin 44, "Rimbursimi për biokarburantet", bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Bazuar në proceset e ndryshimeve teknologjike dhe në përputhje me ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008, "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", të ndryshuar, do të konsiderohen biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse të rinovueshme për transport produktet e mëposhtme:

a) Produktet që klasifikohen në kodin 27 10 20 të NK, në rastet kur produkti BIO i përzier me karburant përbën më pak se 30% të volumit;

b) Produktet që klasifikohen në kodin 38 26 00 të NK kur produkti BIO i përzier me karburant përbën më shumë se 30% të volumit.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Përqindja maksimale e lejuar për efekt të rimbursimit të akcizës për praninë e përbërësve BIO në karburant sipas standardeve EN: 590 për gazoilin dhe EN: 228 për benzinën, janë përkatësisht, 7 (shtatë) dhe 7 (shtatë) për qind.".

Neni 3

Nenet 45 e 46 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 45
Prodhimi dhe mbajtja e biokarburanteve

Prodhimi dhe mbajtja e biokarburanteve realizohen vetëm në magazinat fiskale të produkteve energjetike.

Neni 46
Procedura e rimbursimit të biokarburanteve

1. Dalja e produktit biokarburant nga regjimi pezullues i magazinës fiskale bëhet me dokumentin DSHA me detyrime të paguara.

2. Depozituesi i miratuar, me përfundimin e procesit të prodhimit, magazinon në një depozitë të veçantë, pjesë e magazinës fiskale, gjithë sasinë e biokarburantit të prodhuar nga njësia e prodhimit dhe njofton zyrën doganore mbikëqyrëse, sipas modelit 1 "Njoftim për prodhim biokarburanti", të aneksit 24, që i bashkëlidhet vendimit nr. 30, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), si struktura përgjegjëse që konfirmon përputhshmërinë e produktit me standardet e harmonizuara shqiptare.

3. Zyra doganore mbikëqyrëse, brenda 1 (një) dite pune nga data e marrjes së njoftimit, paraqitet te depozituesi i miratuar dhe verifikon sasinë e produktit, merr mostrat e nevojshme dhe plumbos depozitën ku është magazinuar biokarburanti i prodhuar. Në përfundim të këtij procesi, nga punonjësit e autorizuar të zyrës doganore mbikëqyrëse mbahet një procesverbal sipas modelit 2 "Procesverbal verifikimi", të aneksit 24, që i bashkëlidhet vendimit nr. 30, datë

14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, dhe, brenda 2 (dy) ditësh pune dërgohen mostrat për analizim në laboratorin doganor.

4. Laboratori doganor, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e marrjes së mostrave, i njofton rezultatin e analizave laboratorike zyrës doganore mbikëqyrëse.

5. Depozita ku është magazinuar biokarburanti qëndron e plumbosur dhe nën mbikëqyrjen doganore. Çdo dalje biokarburanti nga kjo depozitë bëhet nën mbikëqyrjen e zyrës doganore duke plotësuar dokumentin DSHA, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, dhe duke përshkruar llojin e produktit në përputhje me të dhënat e certifikatës së analizave e numrin e certifikatës.

6. Në asnjë rast hedhja për konsum/çlirimi i mallit nuk mund të kryhet pa marrë konfirmimin për konformitetin e produktit, sipas kërkesave të standardit të harmonizuar shqiptar nga struktura përgjegjëse (Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial). Konfirmimi nga ISHTI-ja duhet të kryhet brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit.

7. Për çdo dalje nga magazina plotësohet njëkohësisht modeli 3 "Kartelë inventari produkti", e aneksit 24, që i bashkëlidhet vendimit nr. 30, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave.

8. Në rast se autoritetet doganore konstatojnë dëmtim të plumbçeve doganore apo mosrakordim të sasive, bllokojnë depozitën, vendosin plumbçet e reja dhe nuk lejojnë dalje të mëtejshme të produktit. Autoritetet doganore kryejnë të gjitha verifikimet dhe veprimet e mëtejshme për të përcaktuar shkaqet dhe evidentuar përgjegjësitë në përputhje me ligjin. Për sasinë e produktit, gjendje në depozitë, rikryhen procedurat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4.

9. Një herë në muaj depozituesi i miratuar paraqet kërkesë për rimbursim të akcizës për sasitë e produktit BIO, të trupëzuar në sasitë e karburanteve të deklaruara për konsum, shoqëruar përkatësisht me dokumentin DSHA me detyrime të paguara dhe me modelin 3 "Kartelë inventari produkti", të aneksit 24, të vendimit nr. 30, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, dhe certifikatën e laboratorit doganor, si dhe faturën e shitjes së produktit te kompanitë e licencuara nga QKL-ja për tregtimin e biokarburantit.

10. Autoritetet doganore, pasi shqyrtojnë kërkesën duke krahasuar të dhënat e deklaruara me rezultatet e laboratorit doganor, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune, autorizojnë ose refuzojnë rimbursimin duke dhënë arsyet në rast refuzimi.

11. Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar dhe ndaj tij zbatohen masat dhe penalitetet e përcaktuara nga ligji.".

Neni 4

Pas nenit 48 shtohet neni 48/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 48/1

Produktet e akcizës pa pullë fiskale që pranohen në një magazinë fiskale stokimi

1. Në zbatim të pikave 7 dhe 8, të nenit 41, të ligjit, pranohen në një magazinë fiskale stokimi:

a) produktet e akcizës të importuara dhe që kanë detyrimin ligjor të pajisen me pullë akcize, por që në momentin e importimit nuk janë të pajisura me pullë akcize:

Hyrja në magazinë fiskale e produkteve të akcizës të importuara dhe të papajisura me pullë akcize kryhet me DAV IM 4, me regjim 4700, si dhe me DSHA importi.

b) pullat e akcizës të qeverisë shqiptare.

Porositja e pullave të akcizës nga ana e depozituesve të miratuar, të autorizuar për stokim të produkteve të akcizës të papajisura me pullë akcize, bëhet sipas së njëjtës procedurë të parashikuar për prodhuesit në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011, të ministrit të Financave, të ndryshuar.

c) pulla fiskale të shteteve të huaja.

i) Hyrja e pullave fiskale të shteteve të huaja kryhet me procedurë importimi IM5, me regjimin e lejimit të përkohshëm 5300. Pas importimit, sasia e pullave fiskale të shteteve të huaja është e ngarkuar automatikisht në magazinën e operatorit në sistemin *Asycuda World* dhe nga sistemi në çdo kohë mund të evidentohet stoku i pullave, gjendje në magazinë.

ii) Dalja nga magazina fiskale e produkteve të akcizës të pajisura me pullë fiskale të shteteve të huaja bëhet me dokument DSHA eksporti, e shoqëruar edhe me DAV eksporti.

iii) Në çastin e daljes nga magazina fiskale të produkteve të akcizës të pajisura me pullë fiskale të huaj hartohet DAV eksporti, me regjim 3153 për sasinë e pullave fiskale që i korrespondon sasisë së produkteve që dalin nga magazina fiskale dhe në të cilat janë vënë pullat fiskale të huaja.

2. Vendosja e pullave të akcizës në ambientet e magazinave fiskale të stokimit kryhet jo më shpesh se dy herë në muaj dhe në prezencë të autoriteteve doganore mbikëqyrëse. Depozituesi i miratuar duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë Zyrës Doganore Mbikëqyrëse, 48 orë përpara fillimit të vendosjes së pullave të akcizës, për sigurimin e pranisë së autoriteteve doganore gjatë procesit të vendosjes së pullave. Procesi i vendosjes së pullave të akcizës fillon pas sigurimit të prezencës së autoriteteve doganore.

3. Në përfundim të procesit të vendosjes së pullave të akcizës në produktet e akcizës hartohet procesverbali përkatës, në të cilin pasqyrohen të gjitha të dhënat në lidhje me sasinë e pullave të akcizës të vendosura, sasinë e produkteve të akcizës sipas llojeve tek të cilat u aplikuan pullat e akcizës, sasinë e produkteve të akcizës të papajisura me pullë akcize, gjendje në magazinë fiskale, sasinë e pullave të akcizës të papërdorura, gjendje në magazinë fiskale, sasinë e pullave fiskale të shteteve të huaja të vendosura në produktet e akcizës dhe sasinë e pullave fiskale të huaja të papërdorura. Procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesi i autoriteteve doganore dhe depozituesi i miratuar.

4. Depozituesi i miratuar mban regjistrime të sasisë së pullave fiskale të përdorura dhe sasisë së pullave fiskale të papërdorura si dhe kryen rakordime me degën doganore mbikëqyrëse sipas përcaktimeve të nenit 85, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave.

5. Kontrolli dhe inventarizimi i pullave fiskale kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 70, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave.

6. Nuk përfshihen në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, produktet e parashikuara në shtojcën 1, të ligjit nr. 61/2012, "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", pjesa III "Duhani dhe nënproduktet e tij" përveç duhanit të grirë.".

Neni 5

Shkronjat "a" dhe "c", të nenit 51, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) Kopje e titullit të lejes apo licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit nëse subjekti për ushtrimin e aktivitetit duhet të pajiset me një licencë apo leje të parashikuar nga shtojca e ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Magazinave fiskale, të cilat deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk kanë pasur detyrim depozitimin e dokumentit të QKL-së, u lihet afat gjashtë muaj, duke filluar nga data hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për depozitimin e dokumentit të QKL-së pranë degës doganore mbikëqyrëse.

c) Dëshmi penaliteti e përfaqësuesit të shoqërisë/administratorit dhe aksionarëve të shoqërisë.".

Neni 6

Në paragrafin e parë, të nenit 65, hiqen fjalët "... dhe tepritë ...".

Neni 7

Në nenin 75 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Emërtimi i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me "Llogaritja e masës së garancisë në lëvizje dhe stokim".

2. Shkronja "c" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Shuma e garancisë për lëndët e para për prodhimin e produkteve energjetike të parashikuara në nenin 50, të ligjit, llogaritet 25 lekë/kg.".

3. Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Shuma e garancisë për lëndët e para "gjethe duhani", për prodhimin e produkteve të duhanit të parashikuara në nenin 78, të ligjit, llogaritet në masën 100% të detyrimit të akcizës, së cilës do t'i nënshtrohej produkti i gatshëm "Duhan i grirë", i prodhuar nga kjo lëndë e parë. Për llogaritjen e produktit të gatshëm "duhan i grirë", i prodhuar nga lënda e parë "Gjethe duhani", do të zbatohen firot sipas përcaktimeve të nenit 36, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave.".

Neni 8

Në nenin 151 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

"1. Për qëllime të neneve 78 deri 80, të ligjit, autoritetet doganore mbajnë në mbikëqyrje:

a) magazinat fiskale të prodhimit/përpunimit të produkteve të duhanit;

b) magazinat fiskale të stokimit të produkteve të duhanit;

c) magazinat fiskale të prodhimit/stokimit të lëndës së parë (Gjethe duhani) për prodhim produktesh duhani.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Të gjitha subjektet grumbulluese të gjethes së duhanit, detyrimisht, duhet të jenë "Depozitues të miratuar".".

Neni 9

Në pikën 3 "prodhim birre", të aneksit 10, "Tabela referuese e disa normativave të harxhimit të lëndës djegëse", fjalët "Sterilizim, pjekje malti" zëvendësohen me "Sterilizim, zierje malti".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë